



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1207/9 prot.

Datë 25.05.2026

V E N D I M
Nr. 705/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.05.2026, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “R-T-ELIS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Skualifikimin ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “R-T-ELIS” SHPK me NIPT: L44003202U dhe me adresë: Fshati Luz, Ndërtesë private, 1 katëshe, Rruga e vjetër Fushë - Krujë - Laç km. 2, Fushë Krujë, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Krujë
*Adresa: Rruga “Ana Komnena”, Godina Poli i Drejtësisë;
Tiranë.*

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK me NIPT: K94016202U, dhe me adresë: *Lagjja “Grumbullimit”, Rruga e Laçit, Pallat i ri, Kati 1, Zona kadastrale nr. 1664, Fushë Krujë Durrës.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.03.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “*Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote*”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “*Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë*”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

II.2. Në datën 17.03.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MARVINA” SHPK	778.410,0 lekë skualifikuar
2. “KEGLI-DURI” SHPK	1.094.495,0 lekë kualifikuar
3. “R-T-ELIS” SHPK	1.250.000,0 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 14.04.2026, operatori ekonomik “R-T-ELIS” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

“Oferta juaj refuzohet per shkak se nuk permbushet kriteri i DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, nenpika nr 1 per pervojen e suksesshme per sherbimet e meparshme te ngjashme me objektin e prokuruar. Ne faturen e ngarkuar ne SPE nuk jane percaktuar sherbimet e kryera dhe per pasoje ne mbeshetje te VKM nr 285/19.05.2021 neni nr 41 pika 3 dhe neni 55 pika nr 4/b oferta refuzohet.”.

II.5. Në datën 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim – Fituesit Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fitues paraprak oferta e operatorit ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 20.04.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563 dhe me numër protokolli nr. 1207/2026 prot, datë 21.04.2026, e operatorit

ekonomik “R-T-ELIS” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK, në këtë procedurë prokurimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 1207/1 Prot datë 22.04.2026, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “R-T-ELIS” SHPK, si dhe kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datë 29.04.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik Vendimin nr. 186/2026, datë 29.04.2026 protokolluar me tonën me nr. 1206/2 prot, datë 29.04.2026, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave operatori ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK ka dorëzuar shkresën e datës 01.05.2026 “Kërkesë për tërheqje” protokolluar me tonën me nr. 1207/3, datë 04.05.2026, e pafirmosur nga ana e administratorit të shoqërisë “R-T-ELIS” SHPK, ku citohet;

“Në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, paraqes kërkesën time për tërheqje nga ankesa me nr aplikimi online: A/2026/6563 procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05- 2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krui”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krui.”.

II.10. Me shkresën nr. 3203 prot., datën 30.04.2026 “Njoftim vendimi”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1206/4 prot, datë 05.05.2026, është depozituar informacioni i autoritetit kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi, së bashku me Vendimin nr. 185, datë 29.04.2026 ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

“R-T-ELIS” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.11. Me shkresën nr. 1207/5 prot., datë 06.05.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga fakti se dokumenti “*FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK*” të dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike (për ankimin me numër ankimi elektronik A/2026/6563 dhe me numër protokoll nr. 1207/2026 prot, datë 21.04.2026) është nënshkruar dhe është aplikuar në këtë sistem nga z. Haki Tufa me cilësinë e Ekonomistit, si dhe nisur nga fakti se shkresa “Kërkesë për tërheqje” datë 01.05.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 1207/3 prot, datë 04.05.2026, nuk është e firmosur dhe e vulosur nga administratori i shoqërisë “R-T-ELIS” SHPK ka kërkuar nga operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, si më poshtë vijon:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 20.04.2026 nëpërmjetë Sistemit të Ankesave Elektronike është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokoll nr. 1207/2026, datë 21.04.2026, e operatorit tuaj ekonomik “R-T-ELIS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krui”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krui.

Nga shqyrtimi paraprak i rubrikës “Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)” në dokumentin “*FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK*” të dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike konstatohet se ky dokument është nënshkruar dhe është aplikuar në këtë sistem nga z. Haki Tufa me cilësinë e Ekonomistit.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në ankimin elektronik me nr. A/2026/6563, datë 20.04.2026, në Sistemin e Ankesave Elektronike nuk figuron asnjë dokument që të vërtetojë se z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori i operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për të hartuar dhe dorëzuar këtë ankim.

Gjithashtu në datën 04.05.2026, nëpërmjetë sistemit elektronik të ankesave, nga ana juaj është dërguar shkresa “Kërkesë për tërheqje” datë 01.05.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 1207/3 prot, datë 04.05.2026, ku njoftoni se jeni tërhequr nga ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokoll nr. 1207/2026, datë 21.04.2026 për procedurën e mësipërme të prokurimit, por kjo shkresë nuk është e firmosur dhe e vulosur nga administratori i shoqërisë tuaj.

Nisur nga sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj dhe konkretisht nga z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK që të na informojë nëse z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori për hartimin dhe dorëzimin e ankesës së sipërpërmendur, si dhe nëse jeni tërhequr ose jo nga kjo ankesë.

Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të nenit 82 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 30, pika 2 e nenit 53, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm paraqitjen e informacionit të sipërkërkuar, nga ana e z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Informacionin e mësipërm për shkak të afateve të shpejta të procedurave të shqyrtimit të ankesave lutemi të na e përcillni brenda tre ditëve nga marrja e kësaj shkrese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.”.

II.11. Me shkresën nr. 1207/6 prot., datë 18.05.2026 me objekt “Rikërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik, në vijim të shkresës nr. 12076/5 prot., datë 06.05.2026 me objekt “Kërkesë për informacion”, si dhe nisur nga fakti që administratori i shoqërisë ankimuese “R-T-ELIS” SHPK nuk ka dërguar informacion lidhur me këtë kërkesë ka rikërkuar nga operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, si më poshtë vijon:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 20.04.2026 nëpërmjetë Sistemit të Ankesave Elektronike është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokolli nr. 1207/2026, datë 21.04.2026, e operatorit tuaj ekonomik “R-T-ELIS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSHH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Nga shqyrtimi paraprak i rubrikës “Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)” në dokumentin “FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK” të dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike konstatohet se ky dokument është nënshkruar dhe është aplikuar në këtë sistem nga z. Haki Tufa me cilësinë e Ekonomistit.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në ankimin elektronik me nr. A/2026/6563, datë 20.04.2026, në Sistemin e Ankesave Elektronike nuk figuron asnjë dokument që të vërtetojë se z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori i operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për të hartuar dhe dorëzuar këtë ankim.

Ndërkohë në datën 04.05.2026, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, nga ana juaj është dërguar shkresa “Kërkesë për tërheqje” datë 01.05.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 1207/3 prot, datë 04.05.2026, ku njoftoni se jeni tërhequr nga ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokoli nr. 1206/2026, datë 21.04.2026 për procedurën e mësipërme të prokurimit, por kjo shkresë nuk është e firmosur dhe e vulosur nga administratori i shoqërisë tuaj.

Nisur nga sa më sipër, me shkresën nr. 1207/5 prot, datë 06.05.2026 “Kërkesë për informacion” dërguar operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK në rrugë postare dhe nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga ana e z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK që të na informojë nëse z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori për hartimin dhe dorëzimin e ankesës së sipërpërmendur, si dhe nëse është tërhequr ose jo nga kjo ankesë.

Deri më sot nga ana e përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK nuk është përcjellë asnjë informacion pranë institucionit tonë përse i përket kërkesës së parashtruar nga ana jonë në shkresën nr. 1207/5 prot, datë 06.05.2026 “Kërkesë për informacion”, ndaj rikërkojmë nga ana juaj dhe konkretisht nga z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK që të na informojë nëse z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori për hartimin dhe dorëzimin e ankesës së sipërpërmendur, si dhe nëse jeni tërhequr ose jo nga kjo ankesë.

Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të nenit 82 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 30, pika 2 e nenit 53, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm paraqitjen e informacionit të sipërkërkuar, nga ana e z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Informacionin e mësipërm për shkak të afateve të shpejta të procedurave të shqyrtimit të ankesave lutemi të na e përcillni brenda tre ditëve nga marrja e kësaj shkrese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.”.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar “, në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 30 pika 1 të Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*” në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni heton të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha provat e paraqitura për zgjidhjen e çështjes duke përcaktuar në mënyrë të pavarur shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson kryesisht nëse një fakt apo një rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK përsa i përket terheqjes nga ankimi administrativ me numër ankimi elektronik A/2026/6562 dhe me numër protokoli nr. 1206/2026 prot, datë 21.04.2026, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e tjera të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë zbatimit të hapave të mëtijshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Akoma më tej, referuar nenit 117 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Në datën 06.03.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

III.1.2. Në datën 17.03.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt -ankimi.

III.1.3.. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. MARVINA” SHPK	778.410,0 lekë skualifikuar
2. “KEGLI-DURI” SHPK	0.094.495,0 lekë kualifikuar
3. “R-T-ELIS” SHPK	1.250.000,0 lekë skualifikuar

III.1.4. Në datën 14.04.2026, operatori ekonomik “R-T-ELIS” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

“Oferta juaj refuzohet per shkak se nuk permbushet kriteri i DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, nenpika nr 1 per pervojen e suksesshme per sherbimet e meparshme te ngjashme me objektin e prokuruar. Ne faturen e ngarkuar ne SPE nuk jane percaktuar sherbimet e kryera dhe per pasoje ne mbeshtetje te VKM nr 285/19.05.2021 neni nr 41 pika 3 dhe neni 55 pika nr 4/b oferta refuzohet.”.

II.5. Në datën 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim – Fituesit Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fitues paraprak oferta e operatorit ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK.

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 20.04.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563 dhe me numër protokoli nr. 1207/2026 prot, datë 21.04.2026, e operatorit ekonomik “R-T-ELIS” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK, në këtë procedurë prokurimi.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 1207/1 Prot datë 22.04.2026, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “R-T-ELIS” SHPK, si dhe kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KEGLI-DURI” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Në datë 29.04.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik Vendimin nr. 186/2026, datë 29.04.2026 protokolluar me tonën me nr. 1207/2 prot, datë 29.04.2026, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.1.8. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave operatori ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK ka dorëzuar shkresën e datës 01.05.2026 “Kërkesë për tërheqje” protokolluar me tonën me nr. 1207/3, datë 04.05.2026, e pafirmosur nga ana e administratorit të shoqërisë “R-T-ELIS” SHPK, ku citohet;

“Në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, paraqes kërkesën time për tërheqje nga ankesa me nr aplikimi online: A/2026/6563 procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05- 2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një million e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.”.

III.1.9. Me shkresën nr. 3203 prot., datën 30.04.2026 “Njoftim vendimi”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1207/4 prot, datë 05.05.2026, është depozituar informacioni i autoritetit kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi, së bashku me Vendimin nr. 186, datë 29.04.2026 ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.1.10. Me shkresën nr. 1207/5 prot., datë 06.05.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga fakti se dokumenti “**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**” të dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike (për ankimin me numër ankimi elektronik A/2026/6563 dhe me numër protokolli nr. 1207/2026 prot, datë 21.04.2026) është nënshkruar dhe është aplikuar në këtë sistem nga z. Haki Tufa me cilësinë e Ekonomistit, si dhe nisur nga fakti se shkresa “Kërkesë për tërheqje” datë 01.05.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 1207/3 prot, datë 04.05.2026, nuk është e firmosur dhe e vulosur nga administratori i shoqërisë “R-T-ELIS” SHPK ka kërkuar nga operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, si më poshtë vijon:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 20.04.2026 nëpërmjetë Sistemit të Ankesave Elektronike është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokoli nr. 1207/2026, datë 21.04.2026, e operatorit tuaj ekonomik “R-T-ELIS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSHH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Nga shqyrtimi paraprak i rubrikës “Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)” në dokumentin “FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK” të dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike konstatohet se ky dokument është nënshkruar dhe është aplikuar në këtë sistem nga z. Haki Tufa me cilësinë e Ekonomistit.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në ankimin elektronik me nr. A/2026/6563, datë 20.04.2026, në Sistemin e Ankesave Elektronike nuk figuron asnjë dokument që të vërtetojë se z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori i operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për të hartuar dhe dorëzuar këtë ankim.

Gjithashtu në datën 04.05.2026, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, nga ana juaj është dërguar shkresa “Kërkesë për tërheqje” datë 01.05.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 1207/3 prot, datë 04.05.2026, ku njoftoni se jeni tërhequr nga ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokoli nr. 1207/2026, datë 21.04.2026 për procedurën e mësipërme të prokurimit, por kjo shkresë nuk është e firmosur dhe e vulosur nga administratori i shoqërisë tuaj.

Nisur nga sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj dhe konkretisht nga z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK që të na informojë nëse z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori për hartimin dhe dorëzimin e ankesës së sipërpërmendur, si dhe nëse jeni tërhequr ose jo nga kjo ankesë.

Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të nenit 82 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 30, pika 2 e nenit 53, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm paraqitjen e informacionit të sipërkërkuar, nga ana e z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Informacionin e mësipërm për shkak të afateve të shpejta të procedurave të shqyrtimit të ankesave lutemi të na e përcillni brenda tre ditëve nga marrja e kësaj shkrese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.”.

III.1.11. Me shkresën nr. 1207/6 prot., datë 18.05.2026 me objekt “Rikërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik, në vijim të shkresës nr. 12076/5 prot., datë 06.05.2026 me objekt “Kërkesë për informacion”, si dhe nisur nga fakti që administratori i shoqërisë ankimuese “R-T-ELIS” SHPK nuk ka dërguar informacion lidhur me këtë kërkesë ka rikërkuar nga operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, si më poshtë vijon:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 20.04.2026 nëpërmjetë Sistemit të Ankesave Elektronike është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokolli nr. 1207/2026, datë 21.04.2026, e operatorit tuaj ekonomik “R-T-ELIS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një million e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSHH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Nga shqyrtimi paraprak i rubrikës “Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)” në dokumentin “FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK” të dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike konstatohet se ky dokument është nënshkruar dhe është aplikuar në këtë sistem nga z. Haki Tufa me cilësinë e Ekonomistit.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në ankimin elektronik me nr. A/2026/6563, datë 20.04.2026, në Sistemin e Ankesave Elektronike nuk figuron asnjë dokument që të vërtetojë se z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori i operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për të hartuar dhe dorëzuar këtë ankim.

Ndërkohë në datën 04.05.2026, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, nga ana juaj është dërguar shkresa “Kërkesë për tërheqje” datë 01.05.2026, protokolluar me tonën me numër nr. 1207/3 prot, datë 04.05.2026, ku njoftoni se jeni tërhequr nga ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6563, datë 20.04.2026 dhe numër protokolli nr. 1206/2026, datë 21.04.2026 për procedurën e mësipërme të prokurimit, por kjo shkresë nuk është e firmosur dhe e vulosur nga administratori i shoqërisë tuaj.

Nisur nga sa më sipër, me shkresën nr. 1207/5 prot, datë 06.05.2026 “Kërkesë për informacion” dërguar operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK në rrugë postare dhe nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga ana e z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS”

SHPK që të na informojë nëse z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori për hartimin dhe dorëzimin e ankesës së sipërpërmendur, si dhe nëse është tërhequr ose jo nga kjo ankesë.

Deri më sot nga ana e përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK nuk është përcjellë asnjë informacion pranë institucionit tonë përse i përket kërkesës së parashtruar nga ana jonë në shkresën nr. 1207/5 prot, datë 06.05.2026 “Kërkesë për informacion”, ndaj rikërkojmë nga ana juaj dhe konkretisht nga z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK që të na informojë nëse z. Haki Tufa është i autorizuar nga administratori për hartimin dhe dorëzimin e ankesës së sipërpërmendur, si dhe nëse jeni tërhequr ose jo nga kjo ankesë.

Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të nenit 82 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 30, pika 2 e nenit 53, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm paraqitjen e informacionit të sipërkërkuar, nga ana e z. Ramazan Tufa në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Informacionin e mësipërm për shkak të afateve të shpejta të procedurave të shqyrtimit të ankesave lutemi të na e përcillni brenda tre ditëve nga marrja e kësaj shkrese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.”.

III.1.12. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të

afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.13. Në nenin 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e komisionit të prokurimit publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.”.

III.1.14. Në nenin 52, të Ligjit nr. 44/2015 “KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” përcaktohet si më poshtë vijon:

Neni 52
Vërtetimi i nënshkrimeve

1. Çdo organ publik i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vërteton nënshkrimet kur dokumenti i nënshkruar kërkohet t'i paraqitet një autoriteti ose organi tjetër publik, të cilit duhet t'i paraqitet dokumenti i nënshkruar.
2. Vërtetimi i nënshkrimit bëhet vetëm kur nënshkrimi është bërë ose pranuar në prani të nëpunësit të organit publik të ngarkuar për këtë qëllim.
3. Shënimi i vërtetimit vendoset afër nën-shkrimit që vërtetohet dhe duhet të përmbajë:
 - a) një deklaratë se nënshkrimi është i vërtetë;
 - b) identitetin e saktë të personit, nënshkrimi i të cilit vërtetohet, si dhe shënimin nëse nëpunësi përgjegjës për vërtetimin është bindur për identitetin e personit dhe nëse nënshkrimi është bërë ose pranuar në prani të tij;
 - c) deklaratën se vërtetimi bëhet vetëm për paraqitjen pranë një autoriteti ose një organi tjetër publik dhe emrin e këtij autoriteti apo organi;
 - ç) vendin dhe datën e vërtetimit, si dhe nën-shkrimin e nëpunësit përgjegjës për vërtetimin dhe vulën zyrtare.
4. Pikat 1 deri në 3 të këtij neni zbatohen për atë që është e mundur edhe për vërtetimin e shenjave të tjera të identifikimit personal.

III.1.15. Në nenet 79, 80, 81 dhe 82, të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “PËR KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar përcaktohet si më poshtë vijon:

Përkufizimi i veprimit juridik

Neni 79

Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile. Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm.

Format e veprimit juridik

Neni 80

Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit. Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial.

Neni 81

Veprimi juridik me shkresë duhet të nënshkruhet nga personi që e kryen atë.

Neni 82

Personi që nuk di, ose që për shkak sëmundje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, ngarkon një person tjetër për këtë qëllim.

Nënshkrimi i këtij personi duhet të vërtetohet nga noteri, duke u treguar shkaku për të cilin personi që ka kryer veprimin juridik nuk ka mundur ta nënshkruajë vetë.

Për veprimet që kryhen në bankat dhe në institucionet e tjera të kreditit, në zyrat postare apo doganore, nënshkrimi i këtij personi vërtetohet nga një nëpunës i autorizuar i këtyre institucioneve.

III.1.16. Lidhur me kërkesën e bërë nga administratori i operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, të dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave me shkresën e datës 01.05.2026 “Kërkesë për tërheqje” protokolluar me tonën me nr. 1206/3, datë 04.05.2026, Komisioni gjykon se nisur nga fakti se kjo shkresë nuk është e firmosur dhe e vulosur nga ana e administratorit të shoqërisë ankimuese “R-T-ELIS” SHPK dhe ku sipas përcaktimve të sipërpërmendura të Ligjit nr. 44/2015 “KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” dhe Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “PËR KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar nuk vërtetohet vullneti i administratorit që të tërhiqet nga ankesa, si dhe nisur edhe nga fakti edhe pas kërkesave të Komisionit të Prokurimit Publik të parashtruara këtij operatori ekonomik ankimues me shkresën nr. 1207/5 prot., datë 06.05.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” dhe shkresën nr. 1207/6 prot., datë 18.05.2026 me objekt “Rikërkesë për informacion”, administrator i kësaj shoqërie nuk ka konfirmuar vullnetin e tij për t’u tërhequr nga ankesa, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK nuk është në kushtet e nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ndaj do të marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura nga ky operator ekonomik ankimues të parashtruara në ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6563 dhe me numër protokoli nr. 1207/2026 prot, datë 21.04.2026.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “Oferta juaj refuzohet për shkak se nuk përmbushet kriteri i DST pika 2.3 Kapaciteti teknik, nenpika nr 1 për përvojën e suksesshme për shërbimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokuruar. Në faturen e ngarkuar në SPE nuk janë përcaktuar shërbimet e kryera dhe për pasojë në mbështetje të VKM nr 285/19.05.2021 neni nr 41 pika 3 dhe neni 55 pika nr 4/b oferta refuzohet” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”, LOTI I III: (REHABILITIM I DIGES SE REZERVUARIT MICJANE -KRUJE”) pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri kualifikues, si më poshtë:

“2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a)Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron), që prokurohet .

Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve të meparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur shërbimet e meparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

III.2.2. Në sistemin e prokurimeve publike (SPE) autoriteti kontraktor ka publikuar preventivin e punimeve objekt prokurimi në dokumentin e emërtuar “Preventivi Bosh Loti 3 Micjane”, duke përcaktuar llojin dhe volumin e zërave të shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

PREVENTIV
OBJEKTI: REHABILITIM I DIGES SE REZERVUARIT MICJANE - KRUJE

Nr.	Nr/an.	Emertimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	3.2	Prerje bime të vogla Ø - 10 cm	m ²	4,895.0		
2	3.101/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , në kanale gjeresi deri 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në tokë (skarpata e diges)	m ³	867.732		
3	2.37/5b	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	m ³	520.639		
4	3.161/1	Rrafshim skarpate në germim, ekskavator 0.5 m ³	m ²	4,895.0		
5	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (Beton për mbingritje të pusëtës së hyrjes)	m ³	2.00		
6	3.415/3	Ura druri. Shtesë me derrasa, 5 cm (Shandore druri)	m ²	1.50		
7	4.124/11	F.V. saracineska inox me fllanxha, Pn16 bar, ø400	cope	1		
Shuma pa TVSH						

T.V.SH 20%	
SHUMA TOTALE	

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “R-T-ELIS” SHPK për përmbushjen të kriterit kualifikues të mësipërpërmendur, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Faturë tatimore shitje elektronike, nr. 15/2025, datë 12.05.2025, e lëshuar nga shoqëria “R-T-ELIS” SHPK për individin z. Avdyl Hithi, me objekt: “Punime sipas situacionit për ndërtim kapanoni”, me vlerë 6.666.666,67 leke pa-TVSH.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.2.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.6. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 3/a të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

- “3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;”.

III.2.7. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.8. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për

shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit, do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit..”.

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*”, LOTI I III: (*REHABILITIM I DIGES SE REZERVUARIT MICJANE -KRUJE*”) të dokumentave të tenderit ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues për zërat e shërbimeve objekt prokurimi të përcaktuara në dokumentin e emërtuar “*Preventivi Bosh Loti 3 Micjane*” të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve publike (SPE), duhet të paraqesë shërbime të ngjashme të realizuara me ente publike në vlerën 20% të fondit limit të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ku për të vërtetuar realizimin e këtyre shërbimeve duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga enti publik për realizimin me sukses të kontratës, si dhe faturën tatimore të shitjes përkatëse, ndërsa në rastin e realizimit të shërbimeve të ngjashme të realizuara me subjekte private, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm faturën tatimore të shitjes ku vlera e shërbimeve të ngjashme duhet të jetë jo më pak se 20% e fondit limit dhe të jenë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “*R-T-ELIS*” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur faturën tatimore të shitjes nr. 15/2025, datë 12.05.2025, ku vërtetohet se ka realizuar me subjektin privat z. Abdyl Hithri

punime civile për ndërtimin e një kapanoni, punime të cilat janë realizuar brenda 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, por bashkalidhur kësaj fature tatimore mungon situacioni i punimeve dhe nuk mund të konstatohet se punimet civile të realizuara në këtë faturë tatimore janë të ngjashme me zërat e shërbimeve objekt prokurimi të përcaktuara në dokumentin e emërtuar “Preventivi Bosh Loti 3 Micjane” të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve publike (SPE).

Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave më datë 14.04.2026 për operatorin ekonomik ofertues “R-T-ELIS” SHPK qëndron, pasi fatura tatimore e shitjes nr. 15/2025, datë 12.05.2025, nuk dëshmon se punimet civile të përmendura në këtë faturë janë të ngjashme me zërat e shërbimeve objekt prokurimi të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentin e emërtuar “Preventivi Bosh Loti 3 Micjane” të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve publike (SPE), duke mosplotësuar kështu kriterin kualifikues të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”, LOTI I III: (REHABILITIM I DIGES SE REZERVUARIT MICJANE -KRUJE”) të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “R-T-ELIS” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues “KEGLI-DURI” SHPK në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.3.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.3.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e

Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.3.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.3.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“R-T-ELIS”* SHPK nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “R-T-ELIS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me numër refetence Nr. REF-78273-03-05-2026, me objekt “Shërbime të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, e ndarë në lote”, me fond limit 5.666.667 (pesëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, Loti 3 me numër refetence të lotit Nr. REF-78270-03-05-2026, me objekt “Rehabilitim i digës së rezervuarit Micjane-Krujë”, me fond limit të lotit 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “R-T-ELIS” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

